

MBËSHTETJA SEKTORIALE BUXHETORE E BE-SË

Reforma e Administratës Publike

MBËSHTETJA SEKTORIALE BUXHETORE E BE-SË

Reforma e Administratës Publike

Shkurt 2021, Prishtinë

Titulli i publikimit:

Mbështetja Sektoriale Buxhetore e BE-së: Reforma e Administratës Publike

Publikuar nga:

Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane

Vendi dhe koha e publikimit:

Prishtinë, shkurt 2021

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

PËRMBAJTJA

Hyrja	6
Përmbledhje ekzekutive	7
Qëllimet e marrëveshjes	8
Numri i indikatorëve, sipas viteve	9
Transhat financiare, sipas viteve	10
Indikatorët për vitin 2018	11
Indikatorët për vitin 2019	12
Indikatorët për vitin 2020	13
Kalendari i zbatimit të marrëveshjes	14
Gjendja e zbatimit të marrëveshjes	15
Zbatimi i indikatorëve në 2018	16
Zbatimi i indikatorëve në 2019	17
Niveli i zbatimit, total (indikatorët)	18
Niveli i zbatimit, total (buxheti)	19

HYRJA

Në dhjetor 2017 Kosova dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Financimit për Programin e Veprimit për Kosovën për vitin 2016 - Pjesa II - Mbështetja Sektoriale Buxhetore.

Në kuadër të kësaj marrëveshje, Kosova ka marr për obligim që të zbatoj reformat në fushën e administratës publike, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe Agjendën Evropiane të Reformave (ERA), drejt krijimit të një administrate publike të pavarur, profesionale dhe në shërbim të qytetarit. Institucioni përgjegjës për koordinimin e zbatimit të marrëveshjes është Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Sipas marrëveshjes, institucionet e Kosovës u zotuan se gjatë 2018-2020 do të zbatojnë 8 reforma në fushën e administratës publike, të cilat do të vlerësohen me anë të 33 indikatorëve. Ndërsa, në anën tjetër Bashkimi Evropian u zotua se zbatimin e reformave të dakorduara do të shpërblej me €22 milion të mbështetjes direkte buxhetore dhe €3 milion në asistencë teknike. Thënë ndryshe, institucionet e Kosovës përmes zbatimit të këtyre reformave do të fitonin një injektim financiar në vlerë prej €22 milion të cilin do të mund të orientonin për përkrahjen financiare të bizneseve, ofrimin e bursave për studentet, ndërtimin e shkollave, spitaleve apo çfarëdo shërbimi tjetër publik në të mirën e qytetarëve.

Prandaj, marrëveshja kishte dy qëllime: (1) avancimin e reformave evropiane në fushën e administratës publike, dhe (2) mbështetjen financiare Qeverisë për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët.

Marrëveshja funksionon në atë formë ku progresi i Kosovës në përmbushje të indikatorëve shpërblehet me transhat e caktuara financiare. Sa më shumë reforma, aq më shumë fonde. Dhe e kundërta.

Qëllimi i këtij publikimi është (1) të ofroj një pasqyre të kuptueshme të përmbajtjes së marrëveshjes; (2) të evidentoj nivelin e zbatimit të reformave të parapara; dhe (3) të kuptoj nivelin e përfitimit të fondeve të BE-së.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Marrëveshja e Financimit për Programin e Veprimit për Kosovën për vitin 2016 - Pjesa II - Mbështetja Sektoriale Buxhetore është paraparë të zbatohet gjatë periudhës 2018-2020.

Në shkëmbim të zbatimit të reformave në fushën e administratës publike, buxheti i Kosovës do fitonte €22 milion të mbështetjes direkte buxhetore nga ana e BE-së, përmes 4 transheve financiare në vlerë prej €5.5 milion secila.

Transhi i parë prej €5.5 milion nuk ka qenë i kushtëzuar me indikator variabil, por vetëm me përmbushjen e 4 parakushteve të përgjithshme, dhe rrjedhimisht është zbatuar në tërësi. Transhi i dytë është zbatuar në vlerë prej €3.11 milion pasi që institucionet e Kosovës kishin përmbushur 7 nga 12 indikatorë variabil. Transhi i tretë është zbatuar në vlerë prej vetëm €0.42 milion pasi që institucionet e Kosovës kishin përmbushur vetëm 1 nga 11 indikatorë variabil.

Pra sipas marrëveshjes deri më sot, institucionet e Kosovës është dashur të zbatojnë 23 reforma specifike dhe të fitojnë €16.5 milion përkrahje drejtpërdrejt buxhetore nga fondet e BE-së. Në vend të kësaj, institucionet kanë zbatuar vetëm 8 reforma specifike dhe kanë fituar €9.03 milion, duke humbur kështu €7.47 milion nga fondet e BE-së.

Humbja e radhës e fondeve të BE-së është indikator shqetësues i mungesës së theksuar të vullnetit politik dhe kapaciteteve administrative në zbatimin e reformave Evropiane.


QËLLIMET E MARRËVESHJES

Marrëveshja identifikoj tetë reforma në fushën e administratës publike për periudhën 2018-2020:

1. Përmirësimi i planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të politikave dhe legjislacionit;
2. Zhvillimi i politikave dhe hartim i legjislacionit sipas qasjes gjithëpërfshirëse dhe empirike;
3. Rritja e profesionalizmit dhe përmirësim i menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike;
4. Përmirësimi shërbimeve administrative për qytetarët dhe bizneset;
5. Reduktim i barrës administrative për qytetarët dhe bizneset;
6. Racionalizimi i administratës publike;
7. Përmirësimi i qasjes publike në dokumente zyrtare;
8. Përmirësimi i qasjes publike në drejtësinë administrative.


Progresi në përmbushjen e këtyre 8 reformave do të matet përmes përmbushjes së 33 indikatorëve variabil të cilat do i shtjellojmë në pjesën e radhës.

NUMRI I INDIKATORËVE, SIPAS VITEVE



TRANSHAT FINANCIARE, SIPAS VITEVE (MILION EURO)

Marrëveshja ka paraparë disbursimin e €22 milion sipas 4 transheve financiare: 1 transh fikse dhe 3 transheve variabile. Secila transh financiare ka vlerën prej €5.5 milion. Transhi “fix” nënkupton që disbursimi i mjeteve nuk është i kushtëzuar me indikatorë specifik, por vetëm me përmbushjen e parakushteve të përgjithshme. Transhi “variabil” nënkupton që shuma totale varet nga niveli i përmbushjes së reformave specifike të dakorduar në mes palëve.



INDIKATORËT PËR VITIN 2018

Indikatori	Vlera financiare (milion EURO)
Zbatimi i të paktën 60% të masave afatshkurta të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) të vitit 2018	0.4
Të paktën 50% e projekt strategjive/politikave sektoriale, koncept dokumenteve dhe ligjeve të miratuara nga qeveria në vitin 2018 i janë nënshtruar konsultimeve publike, në përputhje me Standardet Minimale për Konsultimin Publik	0.4
Publikimi i raportit vjetor mbi masat disiplinore të marra në vitin 2018 kundër nëpunësve civilë për shkeljen e dispozitave të etikës dhe kundër korrupsionit	0.18
Qeveria miraton ndryshimet legjislative të nevojshme për të mundësuar, në bazë të një vendimi gjyqësor, pezullimin e zyrtarëve publik të akuzuar për veprat penale të korrupsionit dhe largimin e zyrtarëve publikë të dënuar për vepra penale të korrupsionit	0.36
Kuvendi i Kosovës miraton ndryshimet legjislative të nevojshme për të mundësuar, në bazë të një vendimi gjyqësor, pezullimin e zyrtarëve publik të akuzuar për vepra penale të korrupsionit dhe largimin e zyrtarëve publikë të dënuar për vepra penale të korrupsionit	0.36
Së paku 15% e procedurave të veçanta administrative të cilat kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative janë harmonizuar me ligjin ose janë shfuqizuar	0.7
Stafi i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë (SKQ), të Zyrës së Planifikimit Strategjik (ZPS) dhe Zyrës Ligjore (ZL) nën Zyrën e Kryeministrit (ZKM) është rritur me 10 profesionistë	0.8
Ndryshimet e miratuara në dokumentet përkatëse legjislative për të siguruar që të paktën 7 organe të pavarur, që aktualisht i raportojnë Kuvendit do të shfuqizohen ose integrohen brenda strukturave qeveritare	0.55
Kuvendi miraton në pako, Ligjin për Organizimin e Administratës Publike, Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin për Pagat	0.55
Të paktën 70% e institucioneve të qeverisë qendrore, të cilave Avokati i Popullit i ka adresuar rekomandime në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 30 nëntorit 2018, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh	0.18
Të paktën 40% e rekomandimeve drejtuar institucioneve të qeverisë qendrore, të lëshuara në vitin 2017 dhe 2018, në të cilat institucionet e qeverisë qendrore janë përgjigjur pozitivisht, janë zbatuar	0.42
Projektligji për Konfliktet Administrative i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	0.6
VLERA TOTALE E TRANSHIT	5.5

INDIKATORËT PËR VITIN 2019


Indikatori	Vlera financiare (milion EURO)
Zbatimi i të paktën 70% të masave afatshkurta të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) të vitit 2019	0.4
Të paktën 70% e projekt strategjive/politikave sektoriale, koncept dokumenteve dhe ligjeve të miratuara nga qeveria në vitin 2019 i janë nënshtruar konsultimeve publike në përputhje me Standardet Minimale për Konsultimin Publik	0.4
Zbatimi i vendimeve të gjyqësore për pezullimin e zyrtarëve publik të akuzuar për vepra penale të korrupsionit	0.45
Zbatimi i vendimeve gjyqësore për largimin nga postet e tyre publike zyrtarët të cilët janë dënuar për vepra penale të korrupsionit	0.45
Së paku 30% e procedurave të veçanta administrative të cilat kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative janë harmonizuar me ligjin ose janë shfuqizuar	0.7
Koncept Dokumenti për Uljen e Barrës Administrative i miratuar nga qeveria	0.8
Së paku 7 organe të pavarur që aktualisht i raportojnë Kuvendit, të shfuqizuar ose të integruar brenda strukturave qeveritare	0.55
Të paktën 10 agjenci në kuadër të qeverisë dhe me më pak se 50 punonjës janë bashkuar ose shfuqizuar ose integruar si një njësi organizative brenda hierarkisë ministrore	0.55
Të paktën 90% e institucioneve të qeverisë qendrore, të cilave Avokati i Popullit i ka adresuar rekomandime në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 30 nëntorit 2019, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh	0.18
Të paktën 50% e të gjitha rekomandimeve drejtuar institucioneve të qeverisë qendrore, të lëshuara në vitin 2018 dhe 2019, në të cilat institucionet e qeverisjes qendrore janë përgjigjur pozitivisht, janë zbatuar	0.42
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve administrative (duke përjashtuar ankesat për gjobat administrative) zvogëlohet për 20%	0.6
VLERA TOTALE E TRANSHIT	5.5

INDIKATORËT PËR VITIN 2020

Indikatori	Vlera financiare (milion EURO)
Zbatimi i të paktën 80% të masave afatshkurta të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) të vitit 2020	0.4
100% e projekt strategjive/politikave sektoriale, koncept dokumenteve dhe ligjeve të miratuara nga qeveria në vitin 2020 i janë nënshtruar konsultimeve publike në përputhje me Standardet Minimale për Konsultimin Publik	0.4
Zbatimi i vendimeve të gjyqësore për pezullimin e zyrtarëve publik të akuzuar për vepra penale të korrupsionit	0.45
Zbatimi i vendimeve gjyqësore për largimin nga postet e tyre publike zyrtarët të cilët janë dënuar për vepra penale të korrupsionit	0.45
Së paku 60% e procedurave të veçanta administrative të cilat kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative janë harmonizuar me ligjin ose janë shfuqizuar	0.7
Të paktën 10% e licencave dhe lejeve për operatorët ekonomik janë thjeshtuar, bashkuar dhe/ose shfuqizuar kundrejt bazës së vitit 2014	0.8
Të paktën 17 agjenci në kuadër të qeverisë dhe me më pak se 50 punonjës janë bashkuar ose shfuqizuar ose integruar si një njësi organizative brenda hierarkisë së ministrisë	1.1
Të paktën 95% të institucioneve të qeverisë qendrore, të cilave Avokati i Popullit i ka adresuar rekomandime në periudhën prej 1 janarit deri më 30 nëntor 2020, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh	0.18
Të paktën 60% e të gjitha rekomandimeve drejtuar institucioneve qendrore të qeverisë, të lëshuara në vitin 2019 dhe 2020, në të cilat institucionet e qeverisë qendrore janë përgjigjur pozitivisht, janë zbatuar	0.42
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve administrative (duke përjashtuar ankesat për gjobat administrative) zvogëlohet për 30%	0.6
VLERA TOTALE E TRANSHIT	5.5

KALENDARI I ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

Marrëveshja funksionon në atë formë ku palët janë dakorduar që Kosova do të përmbush të gjithë indikatorët deri në fund të vitit respektiv (2018, 2019 dhe 2020). Pas fundit të vitit respektiv, deri në muajin maj të vitit vijues Komisioni Evropian do bënë vlerësimin e pavarur mbi zbatimin e indikatorëve. Në varësi prej vlerësimit, deri në muajin shtator të njëjtit vit Komisioni Evropian do kalojë në buxhetin e Kosovës shumën e caktuar të mjetëve.



GJENDJA E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

Marrëveshja e Financimit për Programin e Veprimit për Kosovën për vitin 2016 - Pjesa II - Mbështetja Sektoriale Buxhetore është paraparë të zbatohet gjatë periudhës 2018-2020.

Në shkëmbim të zbatimit të reformave në fushën e administratës publike, buxheti i Kosovës do fitonte €22 milion të mbështetjes direkte buxhetore nga ana e BE-së, përmes 4 transheve financiare në vlerë prej €5.5 milion secila.

Transhi i parë prej €5.5 milion nuk ka qenë i kushtëzuar me indikator variabil, por vetëm me përmbushjen e 4 parakushteve të përgjithshme, dhe rrjedhimisht është zbatuar në tërësi. Transhi i dytë është zbatuar në vlerë prej €3.11 milion pasi që institucionet e Kosovës kishin përmbushur 7 nga 12 indikatorë variabil. Transhi i tretë është zbatuar në vlerë prej vetëm €0.42 milion pasi që institucionet e Kosovës kishin përmbushur vetëm 1 nga 11 indikatorë variabil.

Pra sipas marrëveshjes deri më sot, institucionet e Kosovës është dashur të zbatojnë 23 reforma specifike dhe të fitojnë €16.5 milion përkrahje drejtpërdrejt buxhetore nga fondet e BE-së. Në vend të kësaj, institucionet kanë zbatuar vetëm 8 reforma specifike dhe kanë fituar €9.03 milion, duke humbur kështu €7.47 milion nga fondet e BE-së.

Në vijim është gjendja e zbatimit të indikatorëve sipas viteve. Këtu nuk janë të përfshira reformat e parapara për vitin 2020, pasi që ato janë shtyrë për vitin 2021 për shkak të efekteve të pandemisë.


ZBATIMI I INDIKATORËVE NË 2018

Indikatori	Vlera financiare (milion EURO)
Zbatimi i të paktën 60% të masave afatshkurta të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) të vitit 2018	0.4
Të paktën 50% e projekt strategjive/politikave sektoriale, koncept dokumenteve dhe ligjeve të miratuara nga qeveria në vitin 2018 i janë nënshtruar konsultimeve publike, në përputhje me Standardet Minimale për Konsultimin Publik	0.4
Publikimi i raportit vjetor mbi masat disiplinore të marra në vitin 2018 kundër nëpunësve civilë për shkeljen e dispozitave të etikës dhe kundër korrupsionit	0.18
Qeveria miraton ndryshimet legjislative të nevojshme për të mundësuar, në bazë të një vendimi gjyqësor, pezullimin e zyrtarëve publik të akuzuar për veprat penale të korrupsionit dhe largimin e zyrtarëve publikë të dënuar për vepra penale të korrupsionit	0.36
Kuvendi i Kosovës miraton ndryshimet legjislative të nevojshme për të mundësuar, në bazë të një vendimi gjyqësor, pezullimin e zyrtarëve publik të akuzuar për vepra penale të korrupsionit dhe largimin e zyrtarëve publikë të dënuar për vepra penale të korrupsionit	0.36
Së paku 15% e procedurave të veçanta administrative të cilat kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative janë harmonizuar me ligjin ose janë shfuqizuar	0.7
Stafi i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë (SKQ), të Zyrës së Planifikimit Strategjik (ZPS) dhe Zyrës Ligjore (ZL) nën Zyrën e Kryeministrit (ZKM) është rritur me 10 profesionistë	0.8
Ndryshimet e miratuara në dokumentet përkatëse legjislative për të siguruar që të paktën 7 organe të pavarur, që aktualisht i raportojnë Kuvendit do të shfuqizohen ose integrohen brenda strukturave qeveritare	0.55
Kuvendi miraton në pako, Ligjin për Organizimin e Administratës Publike, Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin për Pagat	0.55
Të paktën 70% e institucioneve të qeverisë qendrore, të cilave Avokati i Popullit i ka adresuar rekomandime në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 30 nëntorit 2018, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh	0.18
Të paktën 40% e rekomandimeve drejtuar institucioneve të qeverisë qendrore, të lëshuara në vitin 2017 dhe 2018, në të cilat institucionet e qeverisë qendrore janë përgjigjur pozitivisht, janë zbatuar	0.42
Projektligji për Konfliktet Administrative i miratuar nga Kuvendi i Kosovës	0.6
TOTALI I TRANSHES	3.11


ZBATIMI I INDIKATORËVE NË 2019

Indikatori	Vlera financiare (milion EURO)
Zbatimi i të paktën 70% të masave afatshkurta të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) të vitit 2019	0.4
Të paktën 70% e projekt strategjive/politikave sektoriale, koncept dokumenteve dhe ligjeve të miratuara nga qeveria në vitin 2019 i janë nënshtruar konsultimeve publike në përputhje me Standardet Minimale për Konsultimin Publik	0.4
Zbatimi i vendimeve të gjyqësore për pezullimin e zyrtarëve publik të akuzuar për vepra penale të korrupsionit	0.45
Zbatimi i vendimeve gjyqësore për largimin nga postet e tyre publike zyrtarët të cilët janë dënuar për vepra penale të korrupsionit	0.45
Së paku 30% e procedurave të veçanta administrative të cilat kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative janë harmonizuar me ligjin ose janë shfuqizuar	0.7
Koncept Dokumenti për Uljen e Barrës Administrative i miratuar nga qeveria	0.8
Së paku 7 organe të pavarur që aktualisht i raportojnë Kuvendit, të shfuqizuar ose të integruar brenda strukturave qeveritare	0.55
Të paktën 10 agjenci në kuadër të qeverisë dhe me më pak se 50 punonjës janë bashkuar ose shfuqizuar ose integruar si një njësi organizative brenda hierarkisë ministrore	0.55
Të paktën 90% e institucioneve të qeverisë qendrore, të cilave Avokati i Popullit i ka adresuar rekomandime në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 30 nëntorit 2019, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh	0.18
Të paktën 50% e të gjitha rekomandimeve drejtuar institucioneve të qeverisë qendrore, të lëshuara në vitin 2018 dhe 2019, në të cilat institucionet e qeverisjes qendrore janë përgjigjur pozitivisht, janë zbatuar	0.42
Kohëzgjatja e përfundimit të lëndëve administrative (duke përjashtuar ankesat për gjobat administrative) zvogëlohet për 20%	0.6
VLERA TOTALE E TRANSHIT	0.42

NIVELI I ZBATIMIT, TOTAL (INDIKATORËT)




Të pa zbatuar



Të zbatuar

NIVELI I ZBATIMIT, TOTAL (BUXHETI)



● Fonde të fituara

● Fonde të humbura

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

